



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Asambleja

Nr. 84 prot.

Tiranë, më 06.02.2023

Vendim

Nr. 6 datë 06.02.2023

*Për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Asamblesë së Akademisë së Shkencave*

Asambleja e Akademisë së Shkencave, e mbledhur më datën 6 shkurt 2022, me rend dite sipas vendimit të Kryesisë nr. 1 datë 04.01.2023, bashkëngjitur, kreu procedurat e parashikuara në nenet 6 dhe 8 të ligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenet 7, 8 dhe 11 të Statutit, për zgjedhjen e anëtarëve të rinj me titullin “Akademik”.

Pasi konstatoi se konkurrimi i kandidatëve është bërë në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara në ligjin nr. 53/25019 sipëreitur dhe në Kriteret specifike dhe procedurat e vlerësimit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Akademisë, përcaktuar në Aneksin 2 të Statutit të Akademisë; si dhe pasi u bë paraqitja e kandidaturave nga Kryetari i Akademisë; Asambleja zgjodhi komisionin e votimit për administrimin statusor të procesit zgjedhor, me këtë përbërje: akad. emeritus, Floran Vila, kryetar, akad. emeritus Dhimitër Haxhimihali, anëtar dhe akademik i asociuar Adrian Civici, anëtar.

Referuar rezultatit të shpallur prej komisionit të zgjedhjeve pas përfundimit të votimit (procesverbali bashkëngjitur), Asambleja, në bazë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”,

Vendosi:

- I. Zgjidhen anëtarë të Asamblesë duke fituar titullin *akademik*:
  1. Për shkencat arkeologjike për titullin “Akademik”, prof. Adem Bunguri;
  2. Për shkencat e zoo-veterinarisë për titullin “Akademik”, prof. Anila Hoda;
  3. Për shkencën e gjuhësisë, për titullin “Akademik”, prof. Valter Memisha.
  
- II. Ceremonia e dorëzimit të diplomave të bëhet me solemnitetin e

parashikuar në Rregulloren për eereimonialin në Akademinë e Shkencave.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

